

# DOKUDAILY

NUMRI I PARË

EDICIONI XXIV

E PREMTE, 1 GUSHT 2025

## MIRË SE VINI NË DOKUFEST!

**Mbi filmat**

Faqe 03 - 04

**Mbi muzikën**

Faqe 09

**Mbi njerëzit**

Faqe 10

FOTO: ELMEDINA ARAPI

LETËR  
MIRËSEARDHJEJE

Midis pasigurisë dhe shpresës:  
“Endless Greed Mental Void”



FOTO: ELMEDINA ARAPI

Të dashur miq,

Teksa përpiqem të shkruaj këtë porosi mirëseardhjeje në këto kohë pasigurie, nuk mund të mos kthehem disa muaj prapa te një tjetër sfidë, ajo e stuhisë së mendimeve dhe vendimit për temën e festivalit. Në fund, vendosëm një të zymtë, të trishtuar dhe diagnostikuese. E quajmë *Endless Greed Mental Void*: një lloj pasqyre e botës në të cilën po jetojmë.

Asnjëherë më parë nuk kemi hezitur kaq shumë para se të paralajmëronim një temë. Jo sepse na mungonte vizioni, por sepse tani vetë vizioni është i dyshimtë.

Në ditët në vijim dhe në shumë filma do të gjeni sfida të panumërta madje edhe më shumë pasiguri e vuajtje: nga fronti i luftës në Ukrainë deri te brigjet e Cape Verde, nga kënetat e Kubës në Everglades, nga Shkretëtira e Atacamas te shpellat e lakuriqëve të Kinës.

Fytyra të paharruara të nënave që akoma i kërkojnë e vajtojnë të pagjeturit në Sri Lanka, një nënë në panik që kërkon fëmijën e saj të ndarë në kufirin jugor të SHBA-së, një nënë e zhdukur e një fëmije në zonat rurale të Kinës, apo nëna e zhdukur e një regjisorit diku në Irlandë. Dhe shumë e shumë të tjerë!

Sfida individuale e kolektive. Vuajtje të thella e shqetësuese. Me ca rreze gëzimi aty-këtu.

Tregime aq të mëdha e regjisorë aq trima sa që të shikosh këta filma e të ndërtosh këtë program të fuste ndjenjën e tmerrit dhe të bekimit në të njëjtën kohë. Sepse të krijosh filma, të flasësh, madje edhe të mendosh është bërë mjaft e vështirë sot me praninë e aq shumë sfidave dhe vuajtjeve të mëdha.

Kur filluam përpilimin e programit të këtij edicioni, po zhvilloheshin dy luftëra. Bombardimet ishin ngjarje ditore, vdekja ishte e pranishme kudo derisa po prisnin në radhë për ushqim në Gaza, ndërsa spitalet ishin vendet më vdekjeprurëse. Deri në momentin që erdhëm në fazën finale, kishte filluar një luftë e tretë me përmasa katastrofale.

Akoma nuk i shihet fundi kësaj çmendurie. Kjo është atmosfera në të cilën po punojmë. Në një botë ku zgjedhja të mos ngresh zërin ndaj padrejtësive po kthehet në normë. Mpirja në ngjarje ditore. Shpresa në një ide të largët.

Për këtë arsye, të shkruash tekstin e mirëseardhjes për një festival filmi ngjan si një luks i pafitur. Si të jetosh në një fluskë. Programi i këtij viti është përpjekje për t’i rezistuar kësaj mpirjeje. Për ta rimarrë gjuhën nga manipulimi. Për të insistuar që akti i tregimit, dëgjimit, dhe mbledhjes, ka rëndësi akoma, dhe se festivalet si ky kanë rëndësi, pavarësisht gjithçkaje dhe përkundër të gjitha pengesave.

Prandaj, do përmbahem nga të shkruarit në mënyrë specifike për filmat dhe ngjarjet dhe gjithçka tjetër që është pjesë e festivalit për të cilat zakonisht shkruaj në raste të tilla. Në vend të saj, po e lë që ju vetë t’i zbuloni të gjitha.

Ju ftoj ta përjetoni festivalin duke ju ofruar këta filma, biseda dhe muzikë, me shpresën se, duke e bërë këtë, ju do të shpërbleheni po aq sa ne u shpërblyem duke e përgatitur atë.

Mirënjohja ime e përzemërt shkon për të gjithë njerëzit e jashtëzakonshëm që e kanë bërë të mundur këtë udhëtim të bukur e këtë ëndërr tonën: sponsorët dhe partnerët tanë bujarë, ekipin e përkushtuar të DokuFest, dhe të gjithë vullnetarët tanë të mrekullueshëm, si dhe regjisorët e artistët që ndanë veprat e tyre me ne këtë vit. Jemi shumë të vetëdijshtëm se ky festival nuk do të ishte i mundur pa ju. Faleminderit!

Gëzuar për një festival të mrekullueshëm për të gjithë ne!

Veton Nurkollari  
Drejtör Artistik

MBI  
FILMAT

Udhëtime të shkurtra në realitete të mëdha

NË BISEDË ME SAMIR KARAHODËN



Njerëzimi po sfidohet nga një tjetër vit me dhunë e luftëra që sjellin me vete edhe shumë dilema morale e ligjore. Këto zhvillime kanë ndikuar edhe në përzgjedhjen e filmave që do të shfaqen në edicionin e 24-t të DokuFestit si reflektim për krizat aktuale, që shoqërohen edhe me rrëfimet nga e shkuara nga filmbërësit e dalluar, që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme me krijimtarinë e tyre. Për përzgjedhësit e filmave kjo detyrë nuk është e lehtë.

Kuratori i programit të filmave të shkurtër, Samir Karahoda pranon se pesha e përgjegjësisë për përgatitjen e programit është e madhe marrë parasysh reputacionin që ka ndërtuar DokuFest prej vitesh.

*“Besoj se publiku dhe mysafirët do ta ndiejnë këtë përkushtim, meqë do të kenë çfarë të shohin, të dëgjojnë e të shijojnë këto ditë, sepse çdo detaj është përgatitur me kujdes gjatë gjithë vitit. Në fund, shpresoj që Prizreni t’ju duket si një kinema e madhe e hapur dhe njerëzit të flasin për filma e jo për politikë, të paktën këto ditë”.*

Duke qenë edhe vet regjisor, “zanat” të cilin e ka mësuar gjatë përvojës shumë vjeçare të përzgjedhjes së filmave, Karahoda ka empati për filmbërësit, por edhe është i ndjeshëm ndaj krijimeve të tyre.

*“Mundohem të mbaj një sy kritik për standardin e festivalit që e kemi krijuar me vite të tëra, por gjithmonë lë hapësirë edhe për zëra të rinj e ende të panjohur që meritojnë të dalin në dritë”.* Për të vështrimi i parë shkon te forma e rrëfimit, pasi sipas tij, aty vërehen aftësitë dhe dora e autorit.

*“Tema mund të jetë e fuqishme, por nëse tregohet në mënyrë të zakonshme, humbet ndikimi. Forma më tregon nëse regjisor i ka guxim për të rrëfyer një temë apo tregim ndryshe. Gjithashtu më intereson sinqeriteti i autorit, estetika që nuk është veç zbukurim, por vjen prej emocioneve të autorit. Kështu, kur ndërtoj programet për shikuesit në kinema, përpiqem të vendos pranë njëri-tjetrit filma me forma të ndryshme, që publiku të përjetojë jo vetëm tregime dhe ide të reja, por edhe mënyra të reja të rrëfimit dhe të ndjerit”.*

Sipas tij, në kategorinë International Shorts sivjet vërehet një vijë e qartë. *“Pavarësisht prej vendit prej nga vijnë apo stilit që përdorin, autorët fokusohen tek temat politike, tek të drejtat e njeriut dhe tek përvojat personale që këto tema prekin përditë. Disa filma tregojnë histori të vogla familjare që pasqyrojnë çështje më të mëdha si migrimi, pabarazia ose humbja; disa të tjerë vijnë si portrete vendesh apo kulturash.*

*Ndërkohë, disa prej tyre thyejnë rregullat klasike të tregimit: eksperimentojnë me formatin, përdorin inteligjencën artificiale, apo edhe pamjet arkivore. Pra, në përgjithësi nuk bëhet fjalë për filma të zakonshëm, por për vepra që duan të provokojnë audiencën dhe të hapin debate për botën ku jetojmë”.*

Në të njëjtën kohë shton se filmi i shkurtër është mjeti më i mirë për të kapërcyer kufijtë më shpejtë e më lirë.

*“Forma e shkurtër e rrëfimit është pikërisht mediumi që i sfidon me më shumë guxim po ashtu edhe kufijtë krijues; si estetikë, tematikë e politikë. Autorët kanë hapësirë më shumë në këtë format për të eksperimentuar, prekin tema si identiteti, migrimi apo intimiteti dhe nuk mundohen t’ia shpjegojnë çdo gjë publikut. Thjesht zgjedhin një temë, e tregojnë në formën që dinë apo edhe formën që ata mendojnë se i përshtatet tregimit dhe të lënë me pyetje që zgjasin më shumë se vetë filmi. Kjo liri, për mua, e bën filmin e shkurtër mediumin më të guximshëm të kinemasë sot”.*

Krahas kësaj ka veçuar edhe programin e ri special “Masters on Short”, që sivjet shpaloset për herë të parë në DokuFest. *“Ideja është që ti shfaqim filmat e shkurtër, të cilët mjeshtrit e kinemasë botërore i kanë realizuar para se të bëheshin të famshëm. Këto punë të hershme tregojnë fillimet e punëve të tyre, tentativat e para, gabimet e vogla dhe guximin për të provuar forma të reja. “Për edicionin e parë të këtij programi kemi zgjedhur katër filma të shkurtër nga Wim Wenders, që është një mundësi e mirë për të parë se si nisi gjuha e tij filmike, shumë kohë përpara klasikëve si Paris, Texas apo Wings of Desire. Mendoj se ky program do t’i frymëzojë sidomos ata që bëjnë filma vetë, sepse tregon që çdo regjisor i madh ka filluar me eksperimente të vogla, me kushte minimale, por me ide të mëdha”.*

Tani audiencës i mbetet që në nëntë ditët e para të muajit gusht krahas dokumentarëve ti shijojnë edhe filmat e shkurtër të përzgjedhur me shumë dashuri e përkushtim për edicionin e 24-të të DokuFestit.



MBI  
FILMAT

## Rrugëtimi nga një ide e vogël në një mision që nuk përfundon

NË BISEDË ME VETON NURKOLLARIN



STILL: LEART RAMA

Në prag të edicionit të 24-të të DokuFest-it, drejtori artistik Veton Nurkollari ka folur lidhur me ndjenjat, kujtimet dhe sfidat që i kanë dhënë formë njëres prej ngjarjeve më të rëndësishme kulturore në rajon.

Pa ambicie të mëdha por me një mision të qartë, festivali nisi si një përpjekje për t'ia rikthyer në funksion kinemanë, në të cilën shfaqja e filmave dikur ishte pjesë e përditshmërisë.

Në këtë intervistë, Nurkollari flet për origjinën e thjeshtë të festivalit, sfidën e ndryshimit të shprehive të audiencës, përzgjedhjen kuratoriale që pasqyron zhvillimet më të fundit në kinematografinë botërore, si dhe për filmat që ai vetë do t'u rekomandonte shikuesve.

Në këtë intervistë për DokuDaily ai vë në pah rrugëtimin 24 vjeçar si dhe thelbin e DokuFest-it, një festival që lindi nga pasioni, që vazhdon me këmbëngulje dhe që frymëzon me përmbajtje.

**DD: Tani që po nis një tjetër edicion i DokuFest-it, si ndiheni?**

VN: *Me flutura në bark.* Po në fakt ndihem mirë. Dhe si mos të ndihem mirë? Edhe një vit, edhe një edicion, edhe një arritje. Pra, jam i gëzuar. Ndoshta paksa i lodhur, por në rregull është.

**DD: Kur e nisët festivalin, a ju shkonte mendja se do të arrinte të bëhej kaq jetëgjatë, duke marrë parasysh edhe faktin se sot shumë nisma në rajon nisin me vrull, por mezi mbijetojnë pas viteve të para?**

VN: Jo, nuk e kam menduar. Neve asokohe nuk kemi pas ambicie. Prandaj të jesh në momentin kur fillon edicioni i 24-t i festivalit, të cilën jetëgjatësi ne nuk e kemi imagjinuar është për t'u ndier mirë dhe krenar.

Por jo, asokohe nuk e kam imagjinuar, nuk kisha se si. Ndoshta nuk është e mundshme të imagjinohet, por kur e mendoj, disa njerëz kanë shumë ambicie.

Por ne nuk e kemi pasur atë ambicie. Pikërisht për këtë arsye ka funksionuar. Nuk kemi pasur ambicien e madhe, nuk kemi pasë lekë, na është dashur ta bëjmë në formën vullnetare me vullnetarë të tjerë. Pra ta shtyjme përpara idenë se një gjë mund të bëhet edhe pa lekë, me shumë vullnet, dashuri.

Të bësh diçka për këtë vend, për këta njerëz, për këtë qytet këtu, kjo ka qenë ambicia jonë e vogël, të mundohemi ta kthejmë kinemanë në këtë qytet. Ambicia jonë ka qenë e vogël. Ambicia jonë ka qenë ajo kinema atje: Lumbardhi, si të bëjmë diçka që ta kthejmë filmin në atë kinema, të punojë kinemaja.

Dhe të tjerëve ju ka pëlqyer, neve na ka pëlqyer. Misioni për ta kthyer filmin në kinema nuk u përmbush as në vitin e parë, as në të dytin, as në të tretin, as në të katërtin dhe na e vazhduam sepse ky ishte misioni ynë dhe ende është. Ende mundohemi, punojmë, luftojmë për at vend e duke luftuar për at vend e bëjmë edhe për këtë qytet, edhe për këtë shtet, për Kosovën, mbi atë edhe për disa qëllime të tjera, që janë qëllime fisnike, të edukimit, sepse rrugës e kemi kuptuar që edhe ky është një lloj i misionit.

**DD: Meqë e cekët dhe më parë kthimin e filmit te kinemaja, si e shihni shprehinë e qytetarëve këtu, për të vizituar kinemanë?**

VN: Po shprehia e njerëzve ndikohet nga shumë gjëra. Dikur, të shkoje në kinema në këtë qytet ka qenë një shprehje e shumë njerëzve, pjesërisht sepse nuk ka pas shprehje të tjera. Tani njerëzit shohin filma në telefonat e tyre, në dhomat e gjumit të tyre, në Netflix, kudo.

Dhe ajo shprehje e dikurshme është gati e pamundshme të kthehet tani, mirëpo, nevoja për kinemanë ekziston ende.

Unë jam koshient, që numrat e shprehitë e dikurshme nuk mund të kthehen sot sepse shprehja e njeriut ka ndryshuar. Ka shumë gjëra të tjera me të cilat mbushet koha dhe kinemaja aty nuk është më primare, por ende ka nevojë e për shkak që ka nevojë, ne mundohemi. Por sa jemi të suksesshëm në sa do të rikthehet, a nëse do të rikthehet unë jam skeptik sepse kinemaja sikur ka qenë nuk ka mundësi të jetë përsëri dhe ajo nuk është vetëm këtu është kudo në botë.

Janë shfaqur shprehje të tjera. Njerëzit e kalojnë kohën e lirë të tyre, shumë më shumë në shpikje të reja teknologjike dhe nuk mund t'i thuash dikujt, mos e përdor telefonin, mos shiko Netflix, por *shko në kinema*.

Por kinemaja e ka një vend të vetin, se sa nuk e di saktë, por ne ofrojmë filma, si me festival edhe jashtë festivalit, duke krijuar programe për DokuKino, duke tentuar të sjellim filma cilësorë, qofshin ato edhe filma të rinj edhe filma ta quaj kështu nga historia e kinemasë dhe mendoj se kjo mund të jetë një mënyrë për të krijuar një numër të konsiderueshëm të audiencës apo publikut.

*Rikthimi sikur ka qenë, për mua, nuk besoj që mund të ndodhë më.*

Mendoj që ne duhet të kuptojmë me kërkesën për rikthim sikur ishte, është kot, por mënyra të tjera, mund të gjenden.



**DD: Gjatë vitesh si ka ndryshuar natyra e krijimit të programeve në DokuFest, duke patur parasysh se këtë vit në program në total janë mbi 250 filma, dhe si është zhvilluar filmbërja gjatë këtyre viteve?**

**VN:** Të krijosh një program për një festival si është DokuFest-i nënkupton fillimisht edukim intern nga ne të cilët punojmë në këtë aspekt. Prandaj ne shohim mjaft, udhëtojmë mjaft, informohemi mjaft dhe gjithë kjo ndikon në formën e asaj se çfarë prezantojmë në fund. Një pjesë e mirë e programit në DokuFest përbëhet nga filma që janë në gara të ndryshme dhe ajo determinon se çfarë përzgjedhim.

Në garë marrim vetëm filma që janë të rinj, jo më të vjetër se një vit e gjysmë, madje një vit, prandaj duhet të jemi shumë të informuar, qoftë nga filmat që na vijnë, ato që i shohim në festivale të tjera ose nga informatat që i marrim. Ne që jemi prapa programit duhet të jemi të informuar mjaft për trendet e reja, filmat e rinj, se çfarë dominon ose është trend ose është interesant e pastaj mundohemi t'i inkorporojmë ose të krijojmë program.

Pjesa tjetër e programit në DokuFest, janë programet e veçanta dhe ato janë lirshëm të kuruara, që përbën një ëndje të veçantë. Atje mund të shprehemi shumë lirshëm, nuk kemi kufizime, të vitit apo temës apo trajtimit të ndonjë çështjeje apo problemi, po është pjesë e vizionit kuratorial të asaj se çka duam të sjellim, çfarë filmash e pse duam t'i sjellim.

Nëse shihni pak më me kujdes do të shihni se për dallim prej viteve të tjera, megjithëse edhe në vite të tjera ka pas, por këtë vit ka shumë më tepër filma fikSION qofshin ata filma të vjetër, qofshin filma të rinj.

Nga filmat e rinj shumica e tyre, janë filma fikSION që kanë edhe ndonjë lidhje me filmin dokumentar, me rregulla, në stil, me mënyrën se si zhvillohet, por lidhshmëria ka të bëjë me filmin dokumentar dhe filmin fikSION dhe ku bashkohen diku, e kjo ka qenë guida që na ka udhëzuar të zgjedhim.

Pse e kemi sjellë është, ta quaj kështu e një historie më të vjetër të programeve në DokuFest dhe filmave në DokuFest, dhe mënyrës se si filmbërësit sidomos në vitet e fundit, përdorin filmin fikSION, rregullat apo mënyrat e filmit fikSION në dokumentar. E neve na u duk interesant të sjellim disa nga filmat më të suksesshëm të këtij subzhanri që shikuesit ta shohin dhe të vërtetohen që filmi dokumentar është një, qoftë në fikSION, qoftë në animacion, në një tërësi, të gjitha janë filma. Ndarja, unë mendoj që është në një proces të rievallimit dhe të riemërtimit, por që nuk na takon neve. Ne e ofrojmë këtë platformë ku shfaqen filmat e kemi dëshirë edhe mundësi të sjellim shumë nga këto gjëra, lloje e trende për shikuesit. Por edhe për filmbërësit nëpër programe të ndryshme të DokuFest-it, sepse shumica e tyre mund të jenë inspiruese për ta.

**DD: Po të ishe shikues i thjeshtë e ta shihje programin nga jashtë, çka do kishe parë dhe çka do i kishe sugjeruar audiencës?**

**VN:** Në rregull, do të provoj. Filmin për hip-hop bendin irlandez *Kneecap*, unë mendoj që është një moment i jashtëzakonshëm, për të parë një film për një bend në një zhanër që e përmenda, ku anëtarët e bendit e luajnë vetveten në një film për bendin që quhet ashtu sikur quhet dhe filmi *Kneecap*.

Jo vetëm për cilësinë e filmit por edhe për momentin interesant ku ndodhet bendi, po edhe momenti politik për akuzat ndaj një anëtarit të bendit. Mendoj që është mjaft aktual për ta parë filmin dhe për t'u njoftuar me një bend vokal në çështjen e Palestinës sidomos po edhe kritik ndaj qeverisë së Britanisë së Madhe. Nga filmat e tjerë: sidomos nga filmat që janë në garë të filmit të gjatë dokumentar, një film irlandez i cili më pëlqeu shumë: *A Want in Her*. Një film kubanez dhe një film kinez që titullohet *Always*.

Një përzgjedhje për mendimin tim mjaft e mirë të zhanreve të ndryshme të filmit dokumentar në një vend. Disa nga filmat në garën ballkanike, kombëtare. Te tre filmat që janë në programin në bashkëpunim me Lumbardhin, që janë një shikim mbrapa, një homazh për regjisorin e madh të ndjerë, David Lynch me filmin *Lost Highway*, filmin *1984*, për romanin e famshëm të George Orwell, një refleksion ose një film për një moment të imagjinuar nga Orwell, i cili për fat të keq tingëllon e duket sikur është i shkruar dhe i bërë për tani. Me një Big Brother i cili kontrollon gjithçka dhe me një tregim dashurie në atë film, por në fakt një alegori e jashtëzakonshme për autokraci të hatashme diçka që po e shohim këtë ditë kudo nëpër botë. Disa filma për muzikë, duke nisur nga filmi për skenën muzikore të Kosovës *Palace of Youth*. Një film për ikonën muzikore multiinstrumentaliste Warren Ellis dhe punën e tij në muzikë por edhe në bamirësi, në ndihmën e tij për një strehimore kafshësh në Indonezi. Ishte paraparë vizita e tij në Kosovë, por për shkaqe praktike nuk u realizua. Por ka dhe shumë filma të tjerë.

MBI  
TEMËN

Bota është e gjitha gjuhë. Duhet veç ta flasim.

NË BISEDË ME RINA METËN DHE BLERTA HAZIRAJN, PËR EDICIONIN E 24-T TË DOKUFEST.

Çka dimë për Dokufest është se temat e përzgjedhura ndër vite bëhen aq familjare sa ngjajnë si fjali që përherë ua kemi njohur kumtin. Prej *Punk Protest Prizren* te *You’ll break mine, I’ll break yours*, prej *Future My Love* te pafundësia boshe e çmendur dhe lakmitare që na nxit ta mendojmë këtë vit, e kemi një hapesirë ku mundemi ta diskutojmë botën qoftë edhe me dhëmbë të thyer, qoftë duke pirë kafën e mëngjesit në Prizren, e qoftë anëkënd botës prej secilitdo vend vijnë vizitorët e DokuFest.

Rina dhe Blerta, e njohin mirë Prizrenin, ato e kanë jetuar këtë qytet me ritmin e festivalit dhe këtë vit kanë punuar në artikulin dhe zhvillimin e temës për këtë vit, që i flet qëndrimit ndaj gjendjes së mpirjes, kësaj diagnoze kolektive që ekipi artistik i festivalit e ka menduar si shtjellën tematike.

Ashtu sikurse thotë dhe Rina: *Fillimisht, referencat përmes të cilave është artikuluar kjo gjendje kanë ardhur nga deklarata, qëndrime dhe krijime të viteve të kaluara, që shpeshherë kanë tingëlluar profetike dhe të frikshme për atë që po ndodh sot. Për ta adresu këtë realitet, ajo që së bashku me DokuFest-in, DAM-AR-in dhe Blertën [Haziraj] kemi insistu është të krijojmë është një hapësirë reflektive, në të cilën ja nalim hezin botës për t’u dhënë emër ndjenjave që na nevojiten për ta përballu krizën në botë, në vend, në vete. Ka qenë e rëndësishme për ne që hapira promovuese e festivalit të mos e shndërrojë DokuFest-in në spektakël, por një kontekst të përbashkët rezistence.*

Duke shfletuar edicione të mëparshme të DokuDaily, fjala “e ardhme” në të gjitha lakimet e saj gjen prani të plotë, e kjo me forcë gati këmbëngulëse. Rina dhe Blerta e kanë një version të mënyrës se si ato e shohin të ardhmen. Blerta e përkufizon si “të ndritshme” e Rina si “të përbashkët”. Por në këtë edicion të DokuFest ne flasim për të tashmen, për çka ka zë vend diskursin e sotëm, duke patur parasysh që gjendemi në kohë thelbësisht të trazuara politike e shoqërore e si kurrë më parë jemi vizivisht kaq pranë marrëzive kolektive.

Duke biseduar për të tashmen, i referohemi urgjencave, të cilat tema i ka kapërthyer në gjuhë dhe artikulin.

Për Blertën urgjencë është: *Identifikimi dhe artikulimi i “asaj” që po i ndodh botës.*

*Të shkruajmë dhe reflektojmë atë që po i ndodhë tokës, mjedisit. Atë që po përjetojnë popujt e ndryshëm në botë. Qoftë lufta, dhuna, shtypja e popujve, pasiviteti ndaj katastrofave shoqërore. Përkthimi i këtyre realiteteve në fjalë dhe fjali që na zgjojnë, na ngacmojnë, në bëjmë të mendojmë, reagojmë përmes një gjuhe që kërkon përgjegjësi.*

Rina ndërkaq i referohet formave se si njerëzit lidhen në botë mes vetes: *Në një moment të hipernormazlimit të krizave, shterrimit emocional dhe informativ është me randësi t’i kuptojmë lidhjet me botën, me njerëzit e afërt, komunitetet, festivalet, artistat me të cilët e ndajmë jetën, si jetike.*

Në çdo hapje të Dokufest e marrim një slogan me vete që i qëndron më pranë thirrjeve kolektive për çështje që qëndrojnë në zembrek të zemrës, por fjala këtë vit merr fuqinë duke u kthyer imazh më vete. Për ta kuptuar këtë operacion, Rina dhe Blerta gjithashtu kanë punuar në të krijuarit e një fjalori, që me shumë ngulm na ndal të ulemi të lexojmë e ta vërejmë rëndësinë e të kuptuarit, e të qenurit të sfiduar apo të ledhatuar prej teksit.

Rina e shpjegon këtë proces kështu: *Fushata ndërtohet mbi fjalën “Endless”, jo vetëm si përshkrim, por si strukturë, si sistem tipografik dhe si gjendje psikologjike. Përmes kësaj strukture tipografike është kriju një peizazh i gjuhës që vazhdimisht rrëshqet, që kurrë nuk rrin brenda një gridi tipik, po vazhdimisht prezantohet e tkurrur ose zgjeruar, një njëfarë tensioni me hapsirën. Pjesë e fushatës është edhe “Fjalori” një “Endless” moment tjetër të cilin po e zhvillojmë bashkë me Blertën dhe i cili ka gjetë konak në të gjitha materialet promovuese të festivalit, me qëllim të krijimit të hapësirave të qetësisë, pauzës, reflektimit, mësimi, emërimit të asaj që ndodhë përreth dhe brenda nesh.*

Në shumë biseda me ekipin, shpesh përmendet nevoja e vetëedukimit dhe e të shtyrit të vetes për të parë për ta parë botën pa paragjykime. Por ky proces, është edhe punë. E shpesh mund ta gjejmë veten duke listuar e renditur arsyet përse ne bëjmë gjërat që bëjmë. Për Blertën, pavarësisht se e cek se kjo punë ia ka mprehur durimin, por gjen kënaqësi në kujdesin që i është dhënë “valles së çdo fjalie” duke theksuar se ky kujdes i përpiktë e ka gjetur vendin e vet në botë edhe jashtë festivalit.



Teksa gëzojnë për bashkëpunimin me njëra-tjetrën, Meta shprehet se një tjetër gëzim i këtij procesi ka qenë leximi i vëmendshëm i shumë autorëve apo tekste të këngëve në një dritë të re si John Berger, Etel Adnan, Susan Sontag, Pier Paolo Passolini Imran Mir, edhe vargje prej këngëve si Lift You nga Moin, edhe bende tjera të injektuara nga Xhaxhi si: The Smiths, Bauhaus, Lankum, Fountains DC, The Fall etj.

Ashtu sikurse fjalët që janë të mbushura në shtresime kuptimore, ato udhëtojnë në mendjet e njerëzve gjersa të rikthehen e të gjejnë veten në vendin e duhur. Si Rina e Blerta, e kanë gjetur një moment të një rikthimi jokonvencional në DokuFest e në Prizren, në format e tyre. Për Blertën e sjell: *Magjia që e rrethon dhe e ndërton DokuFestin. Njerëzit frymëzues të festivalit dhe mësimet që i kam marrë prej tyre. Bisedat e gjata për kinemanë, për filmin, muzikën. Mbi të gjitha, ajo ndjenja e fortë e ngazëllimit që të përcjellë sa herë që vjen në Prizren, e cila ndryshon çdo vit, por gjithmonë është e ngrohtë.*

Ndërsa Rina e sheh këtë ardhje të disatë është si formë e të qenurit në një vend ku gjithmonë do të mund të përkasësh: *Për mu, shtylla kryesore e DokuFest-it si festival filmi, si akt rezistence, si një lëvizje punk, është dhe mbetet Veton Nurkolari. Vizioni i tij artistik edhe human, mënyra si ai e ndërton festivalin si një hapësirë të vërtetë dhe të pazavedësushme, është arsyeja pse kam ardhë në Doku në vitin 2003 dhe pse vazhdoj të kthehem.*

Ne ju ftojmë ta mendoni botën e ta njihni me të gjitha mjetet që janë të mundshme të përdoren. Fjalët i kemi shpikur vetë e vijojmë t’i rishpikim, që të prekim terri-tore të eksperiencës që i ndiejmë edhe në gjuhë tek lëvizin.

MBI  
TË RINJTË

Për të gjitha tregimet që kanë rëndësi

NË BISEDË ME EROLL BILIBANIN



Dokudaily flet me Eroll Bilibanin, drejtori i DokuLab në DokuFest, për të gjitha programet dhe partneritetet që janë realizuar ndër vite, si dhe bashkëpunimet e reja që do të hapin mundësi emocionuese për të gjithë kineastët e rajonit. Edicioni i këtij viti nis sot, por gjithë puna e bërë përpara festivalit do të shërbejë për t’ju mirëpritur në shfaqje, në biseda dhe në emocionet që sjellin filmat e brezave të rinj për ekranin e madh.

**DD:** Prej 13 vitesh, DokuFest ka mirëpritur sesionet e programit Future is Here, i cili fton të rinjtë të mësojnë dhe të eksperimentojnë me filmin. Gjatë këtyre viteve, kemi parë zhvillime në trajtimin e temave që variojnë nga ato kolektive dhe historike, deri te rrëfimet intime dhe personale. Çfarë zhvillimesh dhe drejtimesh narrative mund të presim nga kineastët e rinj këtë vit?

**EB:** Ajo që bie në sy këtë vit është se sa personale dhe eksperimentale janë bërë filmat e tyre. E ndjen në humorin dhe lojën e një parodie superheroike, në singheritetin e zhveshur të jetesës me aftësi të kufizuara dhe në bisedat familjare që shpalosen si rrëfime. Në të njëjtën kohë, ka vepra që shtrihen jashtë vetes: përditshmëria e një ushtari në një botë të dominuar nga burrat, ose një portret kolektiv i Termokiss dhe shpirtit të komunitetit. Krah për krah, kemi intimen dhe kolektiven, dhomën plot objekte të harruara dhe një meditime abstrakte për atë që do të thotë “shtëpi”. Ajo që më emocionon nuk janë vetëm temat, por mënyrat se si po tregohen. Kineastët e rinj po kërkojnë forma të reja, gjuhë të reja, duke refuzuar të pajtohen me konvencionalen.

Jam jashtëzakonisht krenar që shoh filma nga brezi i 13-të i këtyre zërave të rinj dhe ambiciozë. Ata nuk janë vetëm e ardhmja e kinemasë këtu, por edhe një pasqyrë e shoqërisë në të cilën jetojmë.

T’i mbështesësh ata do të thotë të sigurosh që historitë e tyre, sado të brishta apo të guximshme, të arrijnë të shfaqen në ekran.

Bashkëpunimi me Institutin Skocez të Dokumentarit në partneritet me British Council përfaqëson një mundësi të jashtëzakonshme për kineastët e rinj, ndërsa disa prej tyre do të prezantojnë projektet e tyre dhe do të mësojnë më shumë gjatë sesioneve të Short Film Forum këtë vit në Prizren. Në lidhje me këtë, Bilibani thotë:

*Këtë vit, Short Film Forum mbledh një shumëllojshmëri zërash. Projektet që kemi përzgjedhur vijnë edhe prej periferive: histori të shenjuara nga heshtja, humbja, kujtesa dhe sfida. Disa janë të papërpunuara, të tjera radikalisht eksperimentale, por të gjitha ndajnë një refuzim për të imituar apo për t’u përshtatur. Me mbështetjen e Ambasadës Suedeze, Sida, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe në partneritet me qendrat e filmit nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.*



Forumi është më shumë se sa prezantime projektesh është përpjekje për të thyer barrierat strukturore që prej kohësh kanë penguar filmin e shkurtër në rajon.

Me udhëheqjen e Jing Haase, po punojmë për ta shndërruar këtë në një qendër të përhershme ku filmat e shkurtër nga Ballkani mund të rriten, të lidhen dhe të gjejnë publikun e tyre. Këtë vit janë tetë filma, vitin tjetër do të shtrihemi edhe më tej në rajon. Filli që i lidh të gjithë është i thjeshtë: urgjenca. Këto janë rrëfimet që duhen treguar tani.

**DD:** Gjithashtu, në lidhje me Short Film Forum, ke pasur mundësinë të jesh pjesë e ekipit përzgjedhës për projektet e reja filmike. Duke pasur këtë rol dhe duke marrë parasysh që ndër vite ke parë zhvillimet e brezave të ndryshëm të kineastëve, edhe në rajon, sa të rëndësishme janë platformat e tilla për zhvillimin e projekteve filmike? Çfarë boshllëku mbushin?

**EB:** Platformat si Short Film Forum janë të rëndësishme sepse mbushin një boshllëk. Në këtë rajon, kineastët e rinj nuk kanë mjaftueshëm hapësirë për të testuar idetë e tyre, për të takuar vendimmarrës, apo për të ushtruar prezantimin e projekteve pa presion.

Me kalimin e kohës, kam parë breza të ndryshëm që kanë kaluar nëpër këtë rrugë dhe ata që kanë pasur qasje në platforma të tilla janë rritur më shpejt, me më shumë vetëbesim. Bëhet fjalë për t’u dhënë mjete dhe dukshmëri në faza të hershme, në mënyrë që projektet e tyre të mbështeten dhe zërat e tyre të dëgjohen.



FOTO: EROLL BILIBANI

**DD:** Gjatë gjithë vitit, DokuFest fokusohet në krijimin e një mjedis që vepron në fushën e dokumentarit dhe filmit të shkurtër, përtej festivalit, duke ndërtuar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri për këdo që do të merret me film. Një prej këtyre programeve ka qenë Breaking Borders në bashkëpunim me SDI (Scottish Documentary Institute), dhe produktet nga ky bashkëpunim do të shfaqen në këtë edicion të DokuFest. A mund të na tregosh më shumë për përfitimet e këtij bashkëpunimi dhe çfarë ka sjellë ai në skenë, kulturë dhe për kineastët?

Breaking Borders ka qenë diçka e veçantë. Në një botë gjithnjë e më e përçarë nga politika, historia dhe kufijtë, literalë apo metaforikë, Breaking Borders ofroi një përgjigje të guximshme: bashkë-krijim. Një partneritet unik mes DokuFest-it në Kosovë dhe Scottish Documentary Institute (SDI), kjo nismë bashkoi kineastë në zhvillim nga skajet e kundërta të Europës në një rezidencë të thellë bashkëpunuese të mbështetur në rrëfim, shkëmbim kulturor dhe vetëdije politike.

Nuk është thjesht për të bërë filma, por për të ndërtuar besim përtej kufijve që zakonisht janë të mbyllur. Me mbështetjen e British Council përmes Collaborative Grants, programi mblodhi tetë ish-pjesëmarrës, katër nga secila organizatë, të cilët kishin marrë pjesë më parë në programet Bridging the Gap të SDI-së apo Future is Here të DokuFest-it. Gjatë 19 ditëve në Prizren, këta kineastë u ftuan të lënë pas rutinat e tyre krijuese dhe të zhyteshin në realitetet e ndërlikuara të botës së njëri-tjetrit.

Ideja ishte e thjeshtë, por e fuqishme: të paturit një bashkëpunim radikal. Përmes punëtorive praktike, bisedave të gjata, shfaqjeve filmike dhe ligjëratave, eksplorimit të vendeve për xhirim dhe mentorimit nga kineastët e njohur Saeed Taji Farouky dhe Kumjana Novakova, pjesëmarrësit kaluan përtej bashkëpunimit të sjellshëm në një territor më të thellë e më të sfidues të krijimit.

**DD:** Programi i këtij viti DokuTalks kombinon panele të ndryshme që flasin për prapaskenat e krijimit të filmit, kontekstin në të cilin jetojnë prodhimet filmike, por edhe çështje që lidhen me kulturën, hapësirat publike dhe kujtesën. Si do ta përshkruaje procesin e përpilimit të këtyre diskutimeve?

**EB:** Kur filluam, nuk kishte një model për të ndërtuar DokuTalks. Asnjë plan "industrial" në vetvete. U mbështetëm në vite të tëra bisedash pa fund, që formësuan mënyrën si flasim për kineastë, aktivizmin dhe artin. Në vitin post-pandemik 2021, me kineastin Dea Gjinoçci, nisëm të eksperimentonim me formatin tradicional të "seksionit të bisedave" në diçka që ndihej e gjallë. Diçka që nuk u përkulte ndaj zhargonit konvencional. Kështu ndodhi DokuTalks: një hapësirë ku kineastët, aktivistët dhe studiuesit shpojnë zhurmën dhe ndajnë histori që kanë vërtet rëndësi.

DokuTalks nuk synojnë pajtim të sjellshëm, por thellim në diskutim. Sfidojnë mënyrën si shikojmë, si kujtojmë dhe si i rimarrim hapësirat publike që po tkurren gjithnjë e më shumë.

**DD:** Çfarë të emocionon më shumë këtë vit lidhur me edicionin e 24-të të DokuFest?

**EB:** Çdo gusht, Prizreni kthehet në një qytet filmi, dhe këtë vit është hera e 24-të që e bëjmë këtë të mundshme. Ajo që më emocionon më shumë është mënyra se si festivali vazhdon të rishpikë veten pa humbur rrënjët. Jam gjithashtu i emocionuar në një mënyrë më të thjeshtë, më njerëzore: të eci rrugëve të Prizrenit të mbushura me njerëz, të takoj miq të vjetër që kthehen vit pas viti, dhe të mirëpres të rinjtë që, shpresoj, do ta mbajnë këtë vend me vete gjatë gjithë jetës. Dhe ajo që pres më shumë: të mblidhemi rreth filmave që kërkojnë të shihen, dhe ta ndajmë atë urgjencë së bashku në një Festival dhe një qytet që e bëjnë të mundur këtë.



# HYRJE NE DOKUNIGHTS

## Festa ja nisi!

SHKRUAR NGA GUS EDGAR-CHAN



FOTO: TUGHAN ANIT

Tetë netë me performanca elektrizuese. Tetë netë për shpirtin e përbashkësisë. Dokunights, programi i larmishëm muzikor i festivalit e që mban një hap gjithmonë në të ardhmen, por rikthehet me shumë fuqi sivjet.

Kuruar nga Nita Deda dhe Leart Rama, edicioni i këtij viti ofron një gjithësi eklektike të artistëve, me kapërcime sonore elektronike që janë të guximshme, me melodi të mëndafshhta të folklorit, me instrumentale tradicionale tepër argëtuese dhe me muzikë që sjell euforinë e klubeve. Vitin e kaluar, DokuNights u mbajt në skenën e mirënjohur të Kino Bahçes, e këtë vit skena shkon pranë qiellit, në Sonar Stage në Kala. Ky vend që mikpret këto mbrëmje muzikore premtan një festë të pambarimtë mbi qytet. E në këtë festë jeni të gjithë të ftuar. Udhë drejt kalasë është mëse shpërblyese.

Leart Rama, kurator në DokuNights, na rrëfen se si ky program është krijuar dhe se çka përfaqëson për të:

*Dokunights ka synuar gjithmonë të jetë kontrakulturë ose më mirë, një program që në mënyrë të vijueshme përpiqet të sjellë energji të re, të kultivojë zëra të rinj e t'i japë qytetit një ngjyrë të re. Programi, prej momenteve fillestare që u formësuar si ide, si koncept, shumë më parë se unë të isha pjesë e Dokufest, e kam ndier gjithmonë si një organizëm që në mënyrë të vijueshme evolon, ndryshon dhe përshtatet me kohët dhe me momentet që bota po përjeton. Një gjë që kurrë s'ka ndryshuar në DokuNights është pasioni për të krijuar një dritare mes të cilës mund të ftohesh në botën e muzikës, ku rregullat e muzikës mund të thyhen apo riimagjinohen: një botë që ne në Kosovë, për shumë arsye, nuk mund ta shohim përditë. Programi i përzgjedhur për këtë vit është pikërisht kjo gjë: kombinimi i çfarë ndihet si urgjente me u shpreh përmes tingujve e çka do mund të na shërojë zemrat sikur vetëm për një minutë të vetme.*

General Sponsor



**ProCredit Bank**

E si mundemi më mirë të shohim përmes kësaj dritareje përpos se mes energjisë çliruese brenda një nate ku festohen ndërldhjet ndërkontinentale? Më 2 gusht, tri setet e **IN2STELLAR** nga Melburni, **Byron Yeats** me bazë në Berlin dhe **Rebiswan** nga Kosova do t'ia nisin festës me atë që Rama e përshkroi si *“një balancë të trance të viteve '90 e 2000, muzika house e rimenduar dhe tekno me një qëllim: ta përjetojmë ekstazën në pistë të vallëzimit.”*

Këta tinguj elektronikë takojnë meloditë tradicionale, në natën e ardhshme, me një natë të shumëpritur tek presim performancën e Shkodra Elektronike, që sjell më të mirën e të dyja botëve.

Më 4 gusht, do të ndjekim etno-kaosin rrëqethës të kuartetit të mirënjohur botëror nga Ukraina, **DakhaBrakha** para se ndjekim **Ibadet Ramadanin** me punën e saj si poete që na bën të udhëtojmë e me solo-albumin e saj të ëndërrt më 5 gusht.

Më 6 gusht, kemi të bëjmë vec me thyerje kufijsh teksa **Cinna Peyghamy**, **YAAND** dhe **urbau**, do të ngjiten në skenë secili e të na paraqesin një seri të kompozicioneve emocionuese e të pakompromista.

Më 7 gusht, **upsammy** dhe **LUXE** na bashkohen, kjo përzgjedhje e Leartit, të cilën ai e përshkruan si të dalë *“me një gjuhë krejt të re dhe shprehia emocionale mes artit të tij qëllon një kulm që zor se kapet, pasi vjen në mënyrë të drejtpërdrejtë prej çiltërsisë së shpirtit të artistit.”* Kjo natë nuk duhet humbur kurrsesi.

Më tej, patjetër që me datë 8 gusht, DokuNights, mirëpret me shumë krenari artistin e mirënjohur **Ylli Limani**, që ka për të na marrë me vete mes stilit të tij vizllues të baladave të ndjera dhe muzikës pop plot dritë, në cka premtotet se do të jetë një nga netët që do të mbahet mend gjatë në festival.

DokuNights do të përmbyllet të shtunën me dy performanca: së pari, do të mirëpresim **Orkestra Berati** që na fton në Kino Lumi, me një festë të madhe për gjithë cfarë do të kemi përjetuar deri në fund të festivalit dhe mandej me **Sound Metaphors DJs**, **Sleep D** dhe **Genc Elezaj** që do të na mbajnë më këmbë deri në agim e duke na ftuar në një moment transhental të të qenurit bashkë. Learti shprehet kështu:

*“Në 6 të mëngjesit të natës së fundit gjithmonë jemi në përqaftim me njëri-tjetrin.”*

Kësisoj mezi presim t'ju shohim në DokuNights!



FOTO: AGON DANA

# MBI NJERËZIT

## Ekipi që punon me zemër për DokuFestin që flet me botën

SHKRUAR NGA FISNIK MINCI



FOTO: SUER CELINA

Prizreni është në prag të shpërthimit të energjisë që quhet DokuFest. Vendet e përgatitura për projektimin e filmave dhe netët me muzikë janë gati për të prituri audiencën, që edhe një herë qytetin e shndërron në zemrën kulturore të rajonit. Një ditë para hapjes së edicionit të 24-të, ekipi i festivalit është në lëvizje të pandërprerë. Në zyrat e vogla, rrugicat e shtruara me kalldrëm dhe në sheshet publike, tani mund të ndjehen ankthi, lodhja, puna dhe dashuria. Të gjitha këto në funksion të artit e promovimit të qytetit.

Drejtoresha ekzekutive e DokuFest, Linda Llulla ka bërë të ditur se pas shumë angazhimeve për përgatitjen e edicionit të 24-të ka ardhur koha që me entuziazëm të plotë të presin filmbërësit dhe filmdashësit nga vendi dhe bota.

*“Pavarësisht shumë vështirësve me të cilat jemi ballafaquar këtë vit, prapë se prapë kemi gjetur mënyrë për të përgatitur një edicion që besoj se do të jetë i paharrueshëm për të gjithë pjesëmarrësit, si në programin e filmave ashtu edhe në atë të muzikës”.*

Linda Dobroshi nga ekipi i Marrëdhënieve me Publikun e përshkruan vitin e DokuFest si një grafik.

*“Ka periudha shumë të qeta, pastaj fillon maji dhe gjithçka ndryshon. Nisin të vijnë njerëzit, qyteti pulson ndryshe dhe ty të mbërthen një ndjesi e përzier mes ngazëllimit dhe nostalgjisë”.* Ajo thotë se përtej dritave, posterëve dhe shfaqjeve, ekziston një punë e madhe që shpesh nuk shihet.

*“Shumë do të doja që njerëzit ta kuptonin sa i rëndësishëm është festivali për qytetin. Se nuk është një ngjarje që ‘ndodh’, por një përpjekje kolektive që lind çdo vit nga përkushtimi i madh”. Këtë vit, ajo mezi pret të jetë e pranishme në dy ngjarje të veçanta: rikthimin e filmit kult të David Lynch, Lost Highway, dhe performancën e Ylli Limanit në netët magjike të DokuNights.*

Të qenit pjesë e festivalit edhe në këtë edicion është emocion i pamposhtur për Vanesa Bellanicën po ashtu nga ekipi i Marrëdhënieve me Publikun. *“Çdo herë ndihem sikur është hera e parë. Nuk është që po tutna, po nuk është që s’po tutna. Është një konfuzion i ëmbël, por e dua shumë këtë festival dhe jam shumë entuziaste për këtë edicion”.*

Malbora Krajku bashkë me Idriz Morinën sivjet kanë kuruar DokuKids me një qasje më të përqendruar me qëllim të ofrimit të një përvoje të re për më të vegjlit.

*“Jemi munduar t’u japim më shumë hapësirë edhe adoleshentëve, por interesimi ka qenë më i ulët. Kjo na shtyn të mendojmë formate të tjera në të ardhmen”.*

*Por me 40 filma të dedikuar për fëmijë dhe bashkëpunime ndërkombëtare si ai me Clermont-Ferrand, DokuKids mbetet njëri prej thesareve të festivalit.*

Për Krajkun përkrahja jo adekuate financiare për festivalin nga autoritetet lokale ka krijuar telashe për organizatorët me ç’rast është dashur të ulet numri i kinemave, stafit dhe vullnetarëve.

*“Pavarësisht kësaj ekipi është tej mase pozitiv për të sjellë një edicion sa më të mirë, me momente të reja, përvoja të veçanta dhe miqësi që nuk harrohen”.*


Ajo pret me padurim edhe programin e filmave “Future is Here” nga regjisorët e rinj, që realizohen gjatë një periudhe disa javore në Prizren.

*“Sivjet vijnë filmat e gjeneratës së 13-të të filmbërësve të rinj. Është një program i veçantë, dhe sikurse cdo vit mundohemi me sjellë zëra të rinj që sjellin tema interesante nga këndvështrimi i tyre”.*

Ndërkaq Alba Çakalli, duhet të merret me secilin detaj. Edhe me një gjobë për përdorim telefoni gjatë ngasjes së veturës. Dhe e ruan qetësinë. *“Në këtë rast bëra një gabim dhe e pranova gjobën”.* Duke u marrë edhe me leje publike të dhëna dyfish, telashe të sigurimit, katalogun me gabime numerike (një numër romak që nuk ekziston!), ajo përfaqëson shpirtin e vërtetë të një producenti festivali: të gjej zgjidhje kreative për çdo problem të pamenduar.

*“Brenda tjetër është moti në natën e hapjes. Por do ta tejkalojmë shiun para hapjes. Do ta tejkalojmë zhurmën e qytetit derisa të nisin projeksionet në kinema. Do ta tejkalojmë çdo pengesë... edhe do të kënaqemi.”*

Pas punës kolosale për të sjellë edhe një edicion të ri, DokuFest edhe njëherë e vërteton se nuk është thjesht një festival. Është një akt dashurie. Një thirrje për bashkim. Një platformë për reflektim dhe veprim. Dhe nuk ka asgjë që mund ta ndalë.

|                                                                                                                                                                                                                                                             |                                                                                     |                                                                                                                                                                         |                                                                                       |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|
| General Sponsor                                                                                                                                                                                                                                             | Principal Partner                                                                   | Principal Partner                                                                                                                                                       | Golden Sponsor                                                                        |
|                                                                                                                                                                            |    |                                                                                      |    |
|                                                                                                                                                                            |    |   |    |
|                                                                                                                                                                          |  |                                                                                    |  |
|                                                                                                                                                                          |  |                                                                                    |  |
|    |  |                                                                                    |  |
|                                                                                                                                                                          |  |                                                                                    |  |
|                                                                                                                                                                          |  |                                                                                    |  |
|                                                                                                                                                                          |  |                                                                                    |  |